

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR. 6124 REP.

NR. 2030 KOL.



KONTRATË SHITJE KUOTE

Ne Tirane, sot, me date 05 Qershor 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), u paraqiten përpara meje Julian Zhelegu, Noter i Dhomës së Noterëve Tirane, me zyre në adresën Rr. Pjetër Bogdani, nr. 13, K. I, palët e mëposhtme:

Shitësi: **Z. Rubin Lica**, shtetas shqiptar, lindur me 07.06.1980 në Divjake, Lushnje, banues në Tirane, mbajtes i letërnjoftimit me nr. personal I00607146G, madhor e me zotësi të plote juridike për të vepruar;

dhe

Blerësi: **Z. Fabian Ndone**, shtetas shqiptar, i biri i Kozmait, lindur me 03.02.1977 në Seman, Fier dhe banues në Tirane, Rr. Myslym Shyri, mbajtes i letërnjoftimit me nr. 030581915 dhe nr. personal H70203032D, madhor e me zotësi të plote juridike për të vepruar;

MEQENESE:

- A. Shitësi zotëron 100% të Kapitalit të Shoqërisë "TREGU I AUTOMJETEVE TIRANE" Sh.p.k, një shoqëri e themeluar e që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L82313027G, me seli në adresën: Tirane, Qendra administrave nr. 5, Rruga "Robert Shwarc, (Selite e vogël), Lagjia nr. 8, Zona kadastrale 8260, Pasuria 6/192, Dyqani nr. 5; (me poshtë referuar "Shoqëria");
- B. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit dhe Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi 50% të Kapitalit të Shoqërisë së lartpërmendur;
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkëlidhur të ortakut të vetëm të Shoqërisë, Palët dëshirojnë të lidhin këtë Kontratë.

PER SA ME SIPER, palët bien dakord si vijon:

1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësi 50% të kapitalit të Shoqërisë « TREGU I AUTOMJETEVE TIRANE » Sh.P.K. Shitësi deklaron dhe garanton se ka marrë nga Blerësi me para në dore dhe në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord prej 50 Leke (pesëdhjetë leke) me lidhjen e kontratës dhe transferon në pronësinë e Blerësit pjesën prej 50% të kapitalit të Shoqërisë.
2. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se pjesët e kapitalit të transferuara këtu, janë në pronësinë e tij të plote e ligjore dhe të lira nga barra hipotekë apo pengje.

3. Blerësi blen 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë dhe me nënshkrimin e kësaj Kontrate struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë ndryshon si me poshtë:
- Z. Rubin Lica bëhet zotërues i 1 kuote të kapitalit që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë; dhe
 - Z. Fabian Ndone bëhet zotërues i 1 kuote të kapitalit që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë.
4. Blerësi pranon pronësinë e Kuotës duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i kuotës brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
5. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të Kuotës objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Kontratë u hartua në katër (4) kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

Kontrata bazohet në nenin 705 të Kodit Civil dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Kontrata u lexua prej palëve, u gjet e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre dhe une Noteri e vertetoj atë sipas ligjit.

PALET

SHITESI
Rubin Lica

Rubin Lica



BLERESI
Fabian Ndone

FABIAN NDONE



NOTERI
Julian Zhelegu





VENDIM
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE
“TREGU I AUTOMJETEVE TIRANE” Sh.P.K.

Sot, me date 25 / 06 / 2019, Ortaku i Vetem i Shoqerise “TREGU I AUTOMJETEVE TIRANE” Sh.P.K. (ne vijim “Shoqeria”), një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L82313027G, me seli ne adresen: Tirane, Qendra administruaive nr. 5, Rruga “Robert Shwarc. (Selite e vogel), Lagjia nr. 8, Zona kadastrale 8260, Pasuria 6/192, Dyqani nr. 5, ne perputhje me Statutin dhe Ligjin 9901/2008, te ndryshuar,

VENDOSI:

1. Te miratoje shitjen e 50% (pesedhete perqind) te kuotave te kapitalit te shoqerise “TREGU I AUTOMJETEVE TIRANE” Sh.P.K. nga ortaku Rubin Lica te z. Fabian Ndone.
2. Te autorizojte lidhjen e kontrates / marreveshjes perkatese pa kufizim kohor dhe sipas kushteve e afateve te percaktuara prej paleve.

Ky Vendim u miratua dhe u nenshkrua rregullisht nga ortaku i vetem i Shoqerise si me poshte vijon:

ORTAKU I VETEM
Rubin Lica

Rubin Lica



AUTORIZIM

Me anen e te cilit autorizoj znj. Brunilda Hasko te paraqitet dhe perfaqesoje Shoqerine perpara Qendres Kombetare te Biznesit per kryerjen e çdo veprimi per regjistrimin e kontratës se shitjes se kuotave te Shoqerise te lidhur ndërmjet Rubin Lica dhe Fabian Ndone.

Ky autorizim lëshohet për një afat te pacaktuar deri ne njoftimin e mbarimit te tagrave te përfaqësimit.

Nënshkruar e vulosur sot, me date 25 qershor 2019.

**Përfaqësuesi Ligjor / Administratori
Rubin Lica**

Rubin Lica



TREGU I AUTOMJETEVE TIRANE SH.P.K.
NIPT - L82313027G
TIRANA-ALBANIA